



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Nr. 1406 Prot.

Vlorë më 20.07.2023

URDHËR
Nr. 74, Datë 20.07.2023
PËR

**ÇELJEN E AFATIT TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR TË GJITHA
PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E
INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË PËR VITIN AKADEMIK
2023-2024**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe në Urdhërin e Përbashkët nr. 10, datë 10.07.2023 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024";

URDHËROJ

1. Çeljen e datës së regjistrimit nga data 29.08.2023 deri në datën 07.10.2023 për kandidatët të cilët kërkojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofrojnë departamentet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Çeljen e datës së aplikimit nga data 02.09.2023 deri në datën 13.09.2023 për kandidatët të cilët kërkojnë të aplikojnë për transferim të studimeve dhe program të dytë studimi në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, që ofrojnë departamentet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
3. Çeljen e datës së aplikimit nga 02.09.2023 -13.09.2023 për kandidatët të cilët kërkojnë të aplikojnë nga Republika e Kosovës, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave romë dhe egjiptiane, në programet me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofrojnë departamentet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
4. Çeljen e datës së aplikimit nga 02.09.2023 -13.09.2023 për kandidatët të cilët kërkojnë të aplikojnë me diplome të huaja të shkolles së mesme, në programet me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve si dhe në programet e

integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofrojnë departamentet e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.

5. Aplikimet në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional dhe Master i Shkencave bëhen pranë sekretarive mësimore deri në datë 04.10.2023 dhe regjistrimi i kandidatëve bëhet në datën 27 tetor 2023.
6. Procedurat e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferimin e studimeve ose program të dytë studimi ne Ciklin e Dytë të studimeve, aplikimi bëhet deri me 04.10.2023 dhe regjistrimi i kandidatit bëhet prej datës 16.10.2023 deri në datën 20.10.2023.
7. Të pranohen në të gjitha programet e studimit të II që ofrojnë departamentet e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, kandidatët për student që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të shpalluara nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të miratuara nga Senati Akademik, të dërguara në MAS.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Dekanët, Zëvendësdekanët, komisionet e përllogaritjeve të pikëve të çdo kandidati, Drejtuesit e Njësive Bazë dhe specialistët e Sektorit të IT-së të respektojnë afatet e vendimarrjes respektive, raportimeve dhe proceduarave të parashikuara në në Urdhërin e Përbashkët nr. 10, datë 10.07.2023 *“Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024”*.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Roland ZISI

